

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit		
Titulli i lëndës:	Turizmi Rural		
Niveli:	Bachelor		
Statusi lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	III		
Numri i orëve në javë:	3		
Vlera në kredi – ECTS:	5		
Koha / lokacioni:			
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. As. Dr. Hysen Sogojeva		
Detajet kontaktuese:	hysen.sogojeva@ushaf.net		
Përshkrimi i lëndës	Kjo lende ofron një përmbledhje të fushave të agroturizmit në rritje të shpejtë, nga qasjet akademike ndërdisiplinore. Informacioni i paraqitur në kurs përfshin teori të bazuara në kërkime dhe metoda të kërkimit shkencor shoqëror përmes të cilave studentët do të vlerësojnë se si agroturizmi kryqëzohet me lëvizjet e tjera të njohura të ushqimit të tilla si turizmi gastronomik, fermë në tryezë, kuzhina rajonale, qëndrueshmëri, shtigje vere, birra artizanale, fermë djathë, bukë artizanale, etj.		
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi natyrisht është zhvillimi i turizmit në zonat rurale (dhe agroturizmi si një formë specifike e turizmit rural) si një burim i mundshëm i të ardhurave financiare për ato zona dhe zhvillimi i tyre në të ardhmen. Një tjetër qëllim është të tregojë aftësitë dhe specifikat e këtij sektori të biznesit në fshatrat e Kosovës, duke ndjekur situatën aktuale dhe zhvillimin në vendet e huaja (veçanërisht në shtetet e BE-së).		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Studentët pas përfundimit të kësaj lende do të pajisen me përvojën dhe aftësitë e nevojshme që të: 1. Përcaktojnë agroturizmin dhe turizmin ushqimor dhe artikulojnë tendencat e fundit dhe ndryshimin e demografisë. 2. Diskutojnë qasjet ndërdisiplinore akademike dhe teorinë kritike mbi agroturizmin. 3. Kuptojnë rolin e produkteve me vlerë të shtuar si në turizëm ashtu edhe në sigurinë ushqimore. 4. Nderlidhin promovimin e qëndrueshmërisë dhe aftësitë pritese të komunitetit me mënyrat e turizmit bujqësor, gastronomik dhe të tjera.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15

Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	4	8
Ushtrime në teren (vizita studimore)	3	2	6
Kollokfiime, seminare	1	1	1
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim	6	3	18
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	1	2
Projektet, prezentimet ,etj			
Totali			125

Metodologjia e mësimdhënies:	Lënda zhvillohet në 15 javë me ngarkesë 2 orë ligjerata në të cilat do të trajtohen konceptet teorike dhe do të ofrohen sqarime lidhur me procesin e zhvillimit të Agroturizmit, si dhe dhe 1 orë ushtrime në grupe në javë. Ushtrimet do të zhvillohen në formë me grupe në të cilat do të diskutohen shembuj konkret. Kjo mënyrë e organizimit të ushtrimeve do t'ju shërbejë studentëve për të përvetësuar në mënyrë logjike konceptet teorike dhe për ta lidhur në mënyrë organike teorinë me aspektet praktike të aktiviteteve në kuader të Agroturizmit. Studentët do të nënshtrohen një testi kontrollues gjatë semestrit dhe një provimi përfundimtar në mbarim të ciklit të plotë të kursit të kësaj lënde.
Metodat e vlerësimit:	Test vlerësues gjatë semestrit 20% Vijueshmeria dhe angazhimi në ore 10% Provimi final i vlerësuar me 70% të notës. Provimi përbëhet prej pyetjeve me përgjigje të mundshme, pyetje të hapura, dhe një rast të studimit.
Literatura	
Literatura bazë:	1. Michal Sznajder et al. (2009), Agritourism, CAB International.
Literatura shtesë:	1. Frederic P. Miller, Agnes F. Vandome, McBrewster John (2010). Agritourism, VDM Publishing. 2. Vijay Kumbhar (2013). Problems and Prospects of Agritourism Business, LAP LAMBERT Academic Publishing.
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Kuptimi i agroturizmit Llojet e Agroturizmit
<i>Java e dytë:</i>	Agro-turizmi dhe politika e zhvillimit rural

<i>Java e tretë:</i>	Destinacionet Agroturistike
<i>Java e katërt:</i>	Shërbimet dhe Produktet në Agroturizëm
<i>Java e pestë:</i>	Biznesi në Agroturizëm
<i>Java e gjashtë:</i>	Marketingu në Agroturizëm
<i>Java e shtatë:</i>	Planifikimi dhe menaxhimi i Agroturizmit Nevoja për planifikim dhe menaxhim
<i>Java e tetë:</i>	Përsëritje / Test vleresues
<i>Java e nëntë:</i>	Akomodimi dhe hotelieria në agroturizëm
<i>Java e dhjetë:</i>	Koncepti i Agroturizmit të qëndrueshëm
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Prezentimet e punimeve seminarike
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Analizë SWOT për zhvillimin e Agroturizmit
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Aktivitetet sportive si pjesë e turizmit rural dhe agroturizmit
<i>Java e katërmbëdhjetë:</i>	Strategjia e zhvillimit të Agroturizmit në Kosovë
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Eko-agroturizmi dhe zhvillimi rural

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Vijueshmëria e rregullt, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në dialog gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është e obligueshme.